

# MICROTOPONYMS OF THE XHEPÇISHT VILLAGE AND POROJ

**Albulena ZULBEARI**

University of Tetova, Faculty of Philology, Albanian Language and Literature

albulena.zulbeari@unite.edu.mk

**UDC 81'373.21(497.751)**

*Professional paper*

## **Abstract**

In this project we will try to let the reader know that the local talk of the vilage Xhepçisht it's similar to the local talks of central geagenis. In this project we have given informations about the position of the village and the population, because these informations helped us to reach the wanted results easier. This project is based on the subject of the onomastic, in the field of the toponymy, we will look closer the microtoponymi of the villages Xhepçisht Džepcsite and Poroj.

Knowing the fact that the toponyms are a strong and very stable base to light up the history and the anticity of our contry we have concentrated our studies at these two villages. Both of these villages are very close to each other, but their names have a total diffrent etimology, also the names of the tribes, or antronyms, patronyms, hydronyms, in a lot of cases are diffrent in one village and the other. Even though they are just two villages, they have a lot of diffrent toponyms, wich are very important beacuse beside anticity they prove for the anticity of the langauge too, wich can be seen on the way these people named these places.

**Key words:** *Toponyms, microtoponyms, locality, hydronyms, history, anticity.*

## **Përmbledhje**

Përmes këtij punimi vëmë në pah, se edhe e folmja e fshatit Xhepçisht është e ngjashme me të gjitha të folmet tjetra të gegërishtes qendrore. Në këtë punim kryesisht jemi ndalur për të parë pozitën e fshatit dhe popullsinë, si dhe mikrotoponimet e fshatrave në fjalë, pasi përmes këtyre të dhënave e kemi pasur më të lehtë për të arritur në përfundimet e dëshiruara. Ky punim është i bazuar në lëndën e onomasikës, kryesisht në fushën e toponimisë, ku nga afër do të ndalemi tek mikrotoponimia e fshatrave Xhepçisht dhe Poroj.

Duke qenë në dijeni të faktit, se toponimet janë një bazë e fortë dhe shumë e qëndrueshme për të nxjerrë në dritë historinë dhe lashtësinë e vendit tonë, ne kemi vështuar pikërisht

onomastikën e këtyre dy fshatrave. Të dy fshatrat janë shumë afër njëri tjetrit, por emrat e tyre ngërthejnë etimologji të ndryshme, gjithashtu dhe mikrotoponimet, antroponimet, patronimet, hidronimet e kështu me radhë, në shumë raste ndryshojnë, gjë që flet dukshëm se sa e pasur është onomastika e këtyre anëve. Fshatrat në fjalë janë të pasur me shumë emërvende të ndryshme të cilat lënë për të dëshiruar nga pikëpamja e zbërthimit të etimologjisë shkencore. Toponimet e fshatrave të përmendur, përveç lashtësisë që tregojnë, ata paraqesin dhe një lashtësi gjuhësore e cila duket nga vendosja e këtyre emrave.

**Fjalët kyçe:** *Toponime, mikrotoponime, vendbanime, hidronime, histori, lashtësi.*

## Hyrje

Toponimet janë një dokument i heshtur. Dëshmi e qartë për historinë, që ndriçojnë pjesëza të errësirës shekullore. Sigurisht çdo vend ka një emër dhe kuptim domethënës, të krijuar gjithnjë mbi baza bindëse e shpesh i lidhur me ngjarje që kanë ndodhur, emra, pushtimet e një kohe të largët, me pronarë tokash e familjesh, forma e ngjyra të relievit, ndërtime të vjetra etj. Të emërtuara natyrshëm ato u mbajtën mend brez pas brezi, por kanë pësuar edhe ndryshime. Disa toponime kanë kuptim, ashtu siç tregon rastësi ndonjë prej tyre, e pa asnjë lidhje, të cilat vështirë se shpjegohen.

Shumica e tyre janë pjesë përbërëse e veprimtarisë së njeriut dhe bartin në vetvete gjurmë të historisë, forma arkaike të materialit gjuhësor, elemente të konceptimit të jetës. Toponimia, për arsye të lidhjeve të saj të ngushta me historinë dhe jetën ekonomike-shoqërore e kulturore të çdo populli, paraqitet si një fushë studimi tepër e vështirë dhe që kërkon gjithmonë njohje të gjerë e bashkërendim të të dhënave ndërdisiplinare.<sup>1</sup>

Punimi rreth studimit të materialit toponimik këtë herë i përfshinë vetëm dy fshatra, Xhepçishtin dhe Porojin të cilët i takojnë komunës së Tetovës. Onomastika është një disiplinë e cila na shërben për të arritur deri te gjurmët historike-shoqërore të popullit, pasi përmes saj ne i analizojmë emrat e vendeve, emrat e njerëzve dhe shohim se si ata kronologjikisht në bazë të kohës kanë ndryshuar apo kanë mbetur ashtu siç kanë qenë, shohim dhe ndikimin e sunduesve të ndryshëm që kanë qenë në këto anë dhe emërtimet që ata i kanë lënë. Mendoj, shumë i rëndësishëm është fakti se përmes kësaj ne arrijmë të zbulojmë edhe origjinën e vendit.

Siç e përmenda dhe më sipër, punimi është i bazuar në dy fshatrat e Tetovës ku kemi bërë një vështrim në aspektin leksiko-semantik të emrave, jemi ndalur te toponimet e drejtpërdrejta,

---

<sup>1</sup> Gjovalin Shkurtaç, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, SHBLU, Tiranë, 2001, f. 65.

kemi vështruar toponimet që kanë për bazë emra bujqësor, emra të blegtorisë, hidronimet, emra që tregojnë objekte pune etj. duke treguar se çfarë gjeneze kanë. Besoj se kemi dhënë një pasqyrë të shkurtër rreth këtyre toponimeve, duke lënë vend që në punimin e ardhshëm të ndalemi dhe të lidhjet e onomastikës me dialektologjinë, etnolinguistikën, fonetikën e morfologjinë.

## **1. Mikrotoponimet e Porojit dhe Xhepçishtit**

Në oronimet e fshatit Xhepçisht dhe Poroji, duke u bazuar në materialin e mbledhur toponimik e antroponimik, del një numër i konsiderueshëm i leksemave. Origjina e tyre në shumicën e rasteve është shqipe, pastaj kemi me origjinë sllave dhe me origjinë turke. Duhet cekur se një numër i leksemave, ato të cilat janë të gjuhës shqipe, përdoren në gjuhën letrare, si p.sh.: shpat-i, kep-i, kodër-a etj.

Pasi vendbanimi i Xhepçishtit është i përzier dhe me popullsi maqedonase, kuptohet se kemi edhe leksema me prejardhje nga sllavishtja si p.sh.: rekë-a-lumi, shumar-i-roje pyjesh, ndërsa ato me bazë nga gjuha turke janë më të pakta, të mbetura si pasojë e sundimit shumëshekullor të Perandorisë Osmane., p.sh.: jaz – lum, jeshil, teferiç- vend i hapur etj. Këtu mund të përmendim se një numër shumë i madh edhe i emrave të përveçëm të njerëzve janë me origjinë nga turqishtja, si dhe një numër i madh i mbiemrave të përveçëm, si p.sh.: Jonuz-i, Bajram-i, Beqir-i, Meme-it, Hasan-i, Idriz-i etj.

### **1.1. Mikrotoponime të drejtpërdrejta:**

ball-i: Ballore.

bjeshkë-a: Bjeshka e Baçellës, Bjeshka e Madhe

gjurë-i (guri)- Gjuri Shpamën, Gjuri Kuç, Gjuri Mullajnit, Gjuri Araushës, Gjurët e Bardhë, Gjurët e Ngusht, Gjuri Hutit.

hise: (turq.pronë, pjesë) ke Hisje Ziberit.

krepishte: (kodër e thatë) Te Krepejshta.

ledinë-a: Ledine Apës Zekë, Ledine Poshtme.

lug-i: Lugi Shllejshët, Lugi Thanave.

mal-i: Mali Musës.

rrafsh-i: Rafsha e Poshtme, Rrafsha e Epërme.

tumba: (kodër në mes rrafshi ose rruge) Tame Asnallevë.

Udhë: Udhë e Kumllës, Udhë e Demer Agës, Udhë e Drunit Madh, Udhë e Xhermës, Udhë e Shkrepi, Udhë e Rudinave, Udhë e Ratajës, Udhë e Shkollës.

### **1.2. Hidronime (emra që lidhen me ujëra rrjedhës):**

baltë-a: Balte Kuçe.

çeshma: Çeshmja e Manit, Çeshmja e Seferit, Çeshmje e Ametit, Çeshmje Temsajës, Çeshme Madhe, Çeshme Sutolës.

prroi: Prroi Dhëlpnës.

tinë: (llumi i Lumit Shpejt), tine rekës

ujë: ujtë ftofët.

### **1.3. Mikrotoponime të cilat në përbërjen e emrit kanë emra nga bota bimore dhe shtazore:**

ah-i: ahishte.

bliri: Blini i Vorreve

bagrem-i: te Bagremat

dardhë-a: Dardhe Egër, Dardhe Naserit.

dushk-i: Dushki Thatë.

ferrë-a: Ferra e Sahitit.

jasika: (sllav.jasika,plepa) Jasikat e Azizit.

lejthi-a: Lethaje Selës, Ledhaje Epërme.

mollë-a: Mollat e Muçurinit, Molle Kuçe.

qershi-a: Çershaje Alifikrisë.

thanë-a: Udha e Thanave.

valltallajk: (vend te i cili bëhet grosha më e mirë)

### **1.4. Toponime që lidhen me pyjet dhe pylltarinë:**

zabel-i: Zabeli Madh, Zabeli Teqës.

### **1.5. Mikrotoponime që lidhen me emra të kafshëve:**

Toponimet e ndërtuara me mjetet e shqipes, duke i kundruar në rrafsh të gjerë, na japin mundësi të shohim se aty zotëron deri në shkallën e një sistemi të tërë emërtimi mbi bazën e emrave të bimëve (përgjithësisht të florës) dhe të kafshëve(faunës), të shumtën e herës në mënyrë bashkëkohësisht të motivueshme.

arushë-a: Shpelle Araushës.

dhëlpër-a: Prroi Dhëlpnës.

hut-i: Gjurët e Hutave.

kal-i: Gjur Kali.

ujk-u: Hurdhe Ukit.

#### **1.6. Mikrotoponime që lidhen me sipërfaqe blegtorale**

livadh-i: Livadhi Madh, Livadhi Xhitës, Livadhet e Hoxheve, Livadhi Ramizit.

#### **1.7. Mikrotoponime që lidhen me sipërfaqe bujqësore:**

arë-a: Arat e Mehmet Agës, Are Jonuzit, Are Shqaut, Are Endit, Are Kuçe, Ara Maj Kanallin, Ara Ndër Kanallin, Ara Hajmali, Arat e Hxhi Tafës, Arat e Nurkeve.

fushë-a: Fushe Madhe, Fusha te Ujti Ftofët, Fushat e Shehrit, Fushe Tabashnajcës.

#### **1.8. Mikrotoponime që lidhen me objekte pune:**

mulli-ni: Udha e Mullejve, Mullejni Dukës.

### **2. Përbërja morfologjike e fjalëformuese e toponimeve:**

Pavarsisht nga tërësia e trajtimit të onomastikës që e ndimonte aspekti etimologjik i studimit të saj, kërkimi i strukturës fjalëformuese mbetet një prej elementeve bazë. Emërtimet në këto dy fshatra dalin sipas tipave të fjalëformimit, edhe atë; fjalë të parme, të prejardhura dhe kompozita. Mikrotoponimet fjalë të parme janë zakonisht fjalë me kuptim të përgjithshëm (apelativa), pa ndonjë mjet fjalëformues,<sup>2</sup> por janë të pakëta. Zakonisht janë të përdorura në rasën emërore të shquar, në numrin njëjës e shumës, p.sh.: *Kodra, Livadhe, Shetgu, Balta, Hurdha* etj.

Kur themi fjalë të prejardhura kemi fjalën për mikrotoponimet të cilat janë krijuar me anë të parashtesave dhe prapashtesave. Numri më i madh është ai me krijimin e prapashtesave se sa me parashtesat.

---

<sup>2</sup> Izmit Durmishi, *Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit*, Taulanti, Gostivar, 2008, f. 99.

### 2.1. Ndajshitesat më të shpeshta në fjalëformimin e mikrotoponimeve janë:

-icë me këtë prapashtesë të burimit sllav e ndeshim këtë mikrotoponim --- *udha e Pallaticës*:

-at me këtë prapashtesë janë formuar kryesisht emra vendesh ---- *te ahat, arat (arat te druni i madh), rrafshat, vneshtat*.

-et kemi këto mikrotoponime --- *te stanet, hendeket, sllogjet, qatepet*.

-(a)llar kjo prapashtesë me preardhje nga gjuha turke gjen përdorim më shumë te patronimet, si: *Bajramallarë, Tafallarë, Teskallarë* etj.

-ishte edhe kjo është një prapashtes mjaft prodhimtare në këto anë. Lidhur me prejardhjen e kësaj kemi disa mendime, por po i referohemi atij të Eqrem Çabejt ku këtë e prapashtes e paraqet si prapashtesë sllave.<sup>3</sup> *Ahishte, krepishte* (krepejshta=kodër e thatë).

-ës është një prapashtes më me shumë përdorim në këto fshatra, p.sh.: *Arat e Vneshtës, Arat e Katës* etj.

### 2.2. Mikrotoponime që dalin vetëm në njëjës

Në këto dy fshatra kemi mikrotoponime që dalin vetëm në numrin shumës si p.sh.: *prroi, reka, shkolla*. Zakonisht me këto mikrotoponime lidhen emrat e objekteve të veçanta që nuk tregojnë ngjarje të caktuar. Në shumicën e rasteve ndiqen nga prafjala **te**, *Te Prroi Dhelpnës, Te Shkolla* etj.

### 2.3. Toponime dyfjalëshe

#### a) emër + emër në rasën gjinore

Ky është ndër tipet më të zakonshme në këto fshatra. *Gjuri i Arashës, Gjuri Zogjve, Prroi i Dhelpnës, Prroi i lopëve, Livadhi Xhitës*.

#### b) emër + mbiemër p.sh.: *Gjuri i Kuç, Gjuri i Shopmë*,

- Toponime ku në përbërjen e tyre kanë tri fjalë:

#### c) emër + emër në gjinore + gjinore p.sh.: *Ara e Mehmet Agës, Ahi Haxhi Tafës*.

#### ç) emër + parafjalë + emër; p.sh.: *Ara Ndër Kanallin, Ara Mbaj Kanallin*.

---

<sup>3</sup> Izmit Durmishi, *Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit*, Taulanti, Gostivar, 2008, f. 103.

## **Përfundimi**

Duke u bazuar gjithmonë në punimin që kemi bërë dhe duke i parë të gjithë këta emra që lidhen me arat, livadhet, fushat, malet, rrugët etj., mund të arrijmë në përfundim se, pavarësisht disa emrave të cilët kanë mbetur si pasojë e pushtuesve të ndryshëm që kemi pasur, ata emra në gjenezë kanë brumin e gjuhës shqipe.

Shohim se shumë emra përdoren ashtu siç janë edhe në gjuhën letrare. Ajo që mund të theksojmë është se pjesa e cila ka mbetur më shumë nga gjuhët e huaja është te prapashtesat, pra te shumica e emrave kemi prapashtesa të turqishtes e sllavishtes, por kjo mbetet te një punim i ardhshëm për t'u studiuar më hollësisht.

## **Bibliografia**

- BALIÛ, Begzat (2016). *Onomastika e Gallapit I*, Prishtinë: Era.
- DURMISHI, Izmit (2008). *Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit*, Gostivar: Taulanti.
- MEMUSHAJ, Rami (2008). *Shqipja standarde: si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Tiranë: Toena.
- MURATI, Xheladin (2009). *Xhepçishti në vite*, Tetovë: Çabej.
- SULEJMANI, Fadil (2016). *Toponimia e malësive të Tetovës*, Prishtinë: Piramida.
- SULEJMANI, Fadil (2006). *Dialektologji*, Tetovë: Arbëria Design.
- SHKURTAJ, Gjovalin (2015). *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë: SHBLU.
- THOMAJ, Jani (1978). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Prishtinë: Rilindja.